



KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Urbanizmit
Periudha raportuese	Prill 2017
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fitore Krasniqi

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.



Në Sektorin e urbanizmit gjatë këtij muaji janë pranuar 191 (njëqind e nëntëdhjetë e një) kërkesa të ndryshme, prej të cilave 24 (njëzet e katër) kërkesa për leje ndërtimi. Janë caktuar kushte ndërtimore për 16 (gjashtëmbëdhjetë) ndërtesa, janë lëshuar 16 (gjashtëmbëdhjetë) leje ndërtimi, ku 4 (katër) prej tyre për ndërtesa të kategorisë II, ndërsa të tjerat 12 (dymbëdhjetë) të kategorisë I, janë lëshuar 12 (dymbëdhjetë) vendime - pëlqime të ndryshme, janë refuzuar 12 (dymbëdhjetë) kërkesa, si dhe janë dhënë shumë informime për plotësim dokumentacioni, aktvendime kompensimi e të ngjashme.

Janë lëshuar - për infrastrukturë.

Të dhëna statistikore për Sektorin e urbanizmit:

Lëndët e pranuar - prill, 2017	Kushte ndërtimore	Leje ndërtimore	Konstatime për refuzim	Vendime-pëlqime
191	16	16	12	12

Krahasimi mes muajve janar- prill 2017.



Leje ndërtimore për infrastrukturë	Pëlqime për punë të infrastrukturës	Konstatime për refuzim	Lejet e përdorimit	mbikëqyrjet (në procedurë)
0	0	1	0	8

Po vazhdon regjistrimi i lëndëve në Sistem të vrojtimit të lëndëve.

Ende nuk është duke proceduar me kërkesat për ndërtesat e papërfunduara, të identifikauara nga procesi i legalizimit për shkak të mangësive ligjore dhe pritet plotësim-ndryshimi i Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Janë realizuar shumë takime me qytetarë për konsulta para aplikimit për leje ndërtimore ose kushte ndërtimore, sidomos për objektet e kategorisë II, ku u janë dhënë sqarimet dhe janë udhëzuar për procedura të mëtutjeshme. Janë realizuar edhe takime të kolegjiut me zyrtarë për gjetjen e zgjidhjeve për lëndët më të komplikuar.

Në sektorin e legalizimit, pasiqë ligji që mbulon fushën e legalizimit ka skaduar në muajin shkurt 2017, vazhdimisht janë informuar palët e interesuara për legalizim që aktualisht nuk mund të vazhdohet me procedura të mëtutjeshme.

Nga ky sektor janë lëshuar 4 (katër) informata, 1 (një) konkluzion, 1 (një) përgjigje dhe 1 (një) dërgesë dokumentacioni në MMPH.

Nga Zyra për regjenerim urban, gjatë këtij muaji raportues janë përfunduar:

- Matje dhe projektimi i QMF-së 3 dhe fillimi i punimit të paramasës dhe parallogarisë për inventarizimin e kësaj QMF-je;
- Finalizimi i projektimit të parkut në 4 parcela në lagjen "Mati";
- Fillimi i projektit për Parkun "Heroinat";

- Verifikimi dhe matja e shkollës fillore në Bardhosh, po ashtu edhe një zgjidhje ideore për çerdhe në këtë lokacion;
- Fillimi i matjeve në çerdhen “Yllkat”;
- Fillimi i projektimit për qëndrimin ditor për të moshuar.

2.AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me planprogramin e Komunës për drejtorinë tuaj .

- Zbatimi i bazës ligjore për planifikim e ndërtim - Shqyrtimi i lëndëve duke respektuar afatet ligjore;
- Vlerësimi i lëndëve nga Grupi profesional- Kolegjiumi, si dhe marrja e vendimeve për lëndët ku ka dilema në zgjidhje;
- Takimet me qytetarë të interesuar për zgjidhjet urbane deri në arritjen e zgjidhjes dhe përgatitjet para aplikimit për kushte ndërtimore;
- Digjitalizimi i plotë i arkivës për qasje dhe përpunim sa më të lehtë, si dhe sistemimi i kopjeve fizike të arkivës;
- Vizitë në shkollën fillore të serbëve në Bardhosh;
- Vizitë në çerdhet “Dielli”, “Yllkat”, “Gëzimi Ynë”;
- Punëtori me NPB dhe Kryetarin për lokalet në Qytezën Pejton, ku do të bëhet uniformimi i reklamave.

3.AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.

- Përfundimi i lëndëve me dokumente konkrete;
- Publikimi i lejeve ndërtimore në ueb-faqen e Komunës;
- Takimet e rregullta të zyrtarëve shqyrtues me grupin profesional- kolegjiun për lëndë konkrete;
- Takime të shumta me qytetarë për konsultim rreth zgjidhjeve urbane, të propozuara, para aplikimit për kushte ndërtimore;
- Implementimi i fazës finale të Projektit të digjitalizimit të arkivës fizike;
- Përgjigje në kërkesa të ndryshme sa i përket punës së sektorit;

- Implementimi i Sheshit të Luleve dhe Librave në sheshin “Skenderbeu”, “Zahir Pajaziti” dhe bulevardin “Nënë Tereza”.

4.AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

- Vazhdohet me zbatimin e bazës ligjore, duke u përpjekur që të respektohen afatet ligjore;
- Vazhdon puna në sistemin e informimit për monitorimin e procedurës së marrjes së lejes së ndërtimit nga qytetarët, si masë e transparencës;
- Po punohet në zgjidhje urbane të ndryshme, deri në miratimin e tyre;
- Vazhdon publikimi i të gjitha lejeve të lëshuara ndërtimore nga Sektori i urbanizmit, duke punuar me kronologji nga lejet më të fundit;
- Vazhdon procedura e futjes së të dhënave në sistemin GIS, përkatësisht të situacioneve të zgjidhjeve urbane, të miratuara me kushte ndërtimore, vendosja e gabariteve të objekteve të planifikuara, për të cilat është lëshuar leja ndërtimore, si dhe sistemi i adresave;
- Gjatë tërë kohës janë duke u identifikuar pengesat në zbatim të planeve.

4.1.2 Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese.

4.1.3 Takimet me palë

Kanë vazhduar takimet me palë ditëve të marta dhe të enjte, me përjashtime edhe ditëve tjera sipas nevojës.

5. Takimet me institucione të tjera.

- Takim me inspektorët e MMPH-së.

6.Diskutime publike / takimet me qytetarë.

- Takim me qytetarët e lagjes “Kalabria” - Kompleksi “Kosova Hawaii Group”.

6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare - 7;

6.1.2 Lëndët e pranuar dhe të përfunduara- 145.

Në tabelë gjeni të dhënat për Sektorin e urbanizmit sa i përket kërkesave të pranuar, të përfunduara për këtë muaj:

<i>Lëndët e pranuar</i>	Gjithsej të përfunduara
191	245

Në shifrën prej 245 lëndëve të kryera, llogariten edhe caktimi i pikave, konkluzionet, informimet e ndryshme, njoftimet publike, aktpërcjellësat, vendim pëlqimet e ndryshme, kushtet ndërtimore, lejet ndërtimore, plotësim kërkesat, lejet e rrënitimit, kompenzime, refuzime.

7.Takime të tjera

- Takime me Drejtorinë e Arsimit, për institucione parashkollore dhe shkolla;
- Takimi me Drejtorinë e Kulturës, për terrene sportive dhe kënde të lodrave;
- Takime të vazhdueshme ProCredit Bank, për parkun “Heroninat” në qendër të Prishtinës;
- Takime me IC-Group KFW-German, ku u prezantua master-plani për ngrohtoren e qytetit;
- Takim me SHFMN “Faik Konica”, për oborrin e shkollës;
- Takime të shumta me zyrtarët e Sektorit ligjor të Komunës.

8.SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

Sfidë për Drejtorinë mbetet edhe mëtutje çështja e trajtimit të lëndëve nga legalizimi për objektet e papërfunduara, të regjistruara në regjistrin e ndërtimeve pa leje, deri në miratimin e ligjit të ri.

9.REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shitesë, etj.

- Të mundësohen trajnime ose vizita zyrtare të stafit sa i përket procedurës për pajisje me leje ndërtimore;

- Të furnizohet drejtoria me pajisje për sistemim të dosjeve fizike të Arkivit, me pajisje për skenim të lëndëve, aparat fotokopjues etj.

10.AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues.

- Vazhdimi me shqyrtimin e lëndëve (aprovim, refuzim);
- Procedimi i lëndëve, sipas afatit kohor të paraparë me ligj;
- Analizat dhe listimi i aktiviteteve të nevojshme përgatitore për sistemin online për pajisje me leje ndërtimore;
- Konsultime me palë në lidhje me projektet- në formë të shtypur në fleta A3 (para fazës së aplikimit për leje);
- Aktiviteti rreth avancimit të shërbimit të informimit të qytetarëve për procedurat e Urbanizmit;
- Vazhdimi i publikimit të lejeve të ndërtimit në ueb-faqe të Komunës;
- Miratimi dhe publikimi i taksës së ndërtimit, si dhe tarifat përkatëse.

TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.